



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 188

Tiranë – E hënë, 10 tetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 6.9.2016	20947
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 23, datë 26.9.2016	20952
Urdhër i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 7478, datë 16.9.2016	20952
Vendim i Komitetit Ndërsektorial, për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit nr. 3, datë 31.5.2016	20957
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 5317, datë 29.9.2016	20957
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4766, datë 4.10.2016	20958
	20959
	20959



UDHËZIM

Nr. 22, datë 6.9.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.7.2016,
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE
TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE ME
KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË,
NË VITIN AKADEMIK 2016–2017**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017”:

UDHËZOJ:

I. Pas kreut IV/I të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, shtohet kreu IV/II, si më poshtë:

“Kreu IV/II

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo transferojnë studimet, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 7 shtator 2016 deri në datën 19 shtator 2016.

2. Kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë, për program të dytë studimi apo transferim studimesh, kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi, përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin nr. 407, datë 1.6.2016 të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh apo për t'u pranuar në programet e

studimeve dyvjeçare me karakter profesional, si program i dytë studimi nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të miratuar.

5. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime të studimeve gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë, për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Kandidati nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi.

6. Aplikimi për transferim studimesh mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtut cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose në IAL private, vendase apo të huaja, të akredituara për programin përkatës të studimit.

7. Të gjithë kandidatët për program të dytë studimi, që kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, duhet të kenë të njohur diplomën/certifikatën e arsimit të mesëm të lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

8. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:

a) Kërkesa drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);

b) Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;

c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

d) Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore se bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e



notave të shkollës së mesme, të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) Dy fotografi personale.

9. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL-ja (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet dhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i) emri, atësia, mbiemri;

ii) datëlindja;

iii) vendlindja;

iv) shtetësia;

v) numri i matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;

vi) emri i shkollës së mesme / IAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi;

vii) ID e Maturës Shtetërore / nr. regj. të veçantë¹;

viii) numri personal i identitetit;

ix) data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;

x) emërtimi i programit të studimit dhe fakulteti përkatës;

xi) cikli dhe forma e studimit;

xii) data e ndërprerjes së studimeve.

10. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) Kërkesa drejtuar IAL-së publike për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit);

b) Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;

c) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);

d) Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në

Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) Dy fotografi personale.

11. IAL-të i përcjellin AKP-së, brenda datës 20 shtator 2016, listën e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare.

12. IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës 21 shtator 2016.

13. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës 30 shtator 2016. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura prej tyre, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet *web* përkatëse, e plotësuar sipas tabelave nr. 1/a dhe 1/b të parashikuara në shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi.

IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës 3 tetor 2016. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

14. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

15. IAL-të shpallin listat përfundimtare me

¹ Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006.



renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës 10 tetor 2016.

16. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2016 deri më datë 14 tetor 2016. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 18 tetor 2016.

17. IAL-të nisin në AKP për t'u pajisur me numër matrikullimi, emrat e studentëve të regjistruar sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit brenda datës 21 tetor 2016.

18. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr. 6 të këtij udhëzimi.

19. Pas shtojcës 4, të udhëzimit nr. 13, datë 22.7.2016, i ndryshuar, shtohen shtojcat 5 dhe 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla



SHTOJCA NR.5

Tabela 1 a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindja	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik 2015–2016	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit fitues/jofitues
												Kriteri 1	Kriteri 2	Etj.	Pikët totale	
1																
2																
3																
....																

Tabela 1 b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindja	Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji (Bachelor, PICD)	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për program të dytë dhe lloji (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit fitues/jofitues	
											Kriteri 1	Kriteri 2	Pikët totale		
1																
2																
3																
....																



SHTOJCA NR. 6

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
 emri atësia mbiemri
 me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.

Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik në të cilin po aplikoj.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur me udhëzimin nr. 13, datë 22.7.2016 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016–2017", i ndryshuar, dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit për transferim/program të dytë studimi, si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

5. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër
i kandidatit

Firma

Emër, mbiemër
i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . _____

**UDHËZIM**

Nr. 23, datë 26.9.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE
SPORTIT NR. 21, DATË 18.8.2016, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E GJIMNAZIT ME KOHË TË
PJESSHME”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “a”, të nenit 26, germës “b”, të nenit 16, dhe pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 69 /2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Neni 3 në udhëzimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 18.8.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e gjimnazit me kohë të pjesshme”, ndryshon si vijon:

“Nxënësi që ka dëftesën e lirim, të fituar brenda vendit ose një dëftesë të njëvlershme me të, të fituar jashtë vendit dhe është mbi 18 vjeç ditën e fillimit të vitit shkollor, ka të drejtë të regjistrohet në klasën e dhjetë të gjimnazit me kohë të pjesshme.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla**URDHËR**

Nr. 7478, datë 16.9.2016

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR TRAJTIMIN E ANKESAVE TË
DEPOZITUARA PRANË
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË
MBIKËQYRJES SË TREGUT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, VKM-në nr. 36, datë 20.1.2016.

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për trajtimin e ankesave të depozituara pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

RREGULLORJA

**E TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË
DEPOZITUARA PRANË INSPEKTORATIT
SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË
TREGUT**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, ligjit nr. 93, datë 27.7.2015, “Për turizmin”, ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, VKM-në nr. 36, datë 20.1.2016, si edhe çdo bazë tjetër ligjore që nuk bie ndesh me parimet e kësaj rregulloreje.

TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Rregullorja e trajtimit të ankesave të depozituara pranë Inspektoratit Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, ISHMT-ja ka si qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për zbatimin e një standardi ligjor, në shqyrtimin dhe disiplinimin efektiv të sjelljeve të subjekteve që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi (persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj) që bien në kundërshtim me:



- Kodin e Procedurës Administrative; dhe
 - dispozitat e ligjit nr. 10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 93, datë 27.7.2015, “Për turizmin”; dhe

- parashikimet e akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Të garantojë të drejtat e palëve, të cilat përfshihen në një proces ankimimi, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Neni 2

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) Shqyrtimi i sjelljeve të subjekteve që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi, në territorin e Republikës së Shqipërisë (persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj), të kryera në shkelje të parashikimeve ligjore, mbi bazën e informacioneve të besueshme;

b) Verifikimi i çdo ankese të paraqitur pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, “ISHMT”, nga persona apo subjekte të tjera, palë të interesuara, të cenuara nga subjekte që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi;

c) Përcaktimi i rregullave për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Vlerësimit të Ankesave (KVA), i zgjedhur nga Kryeinspektori;

d) Përcaktimi i kohëzgjatjes dhe mënyrës së trajtimit të ankesave apo rasteve objekt i kësaj rregulloreje, nga Komisioni i Vlerësimit të Ankesave (KVA).

Neni 3

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në ligjet, ligji nr. 10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 93, datë 27.7.2015, “Për turizmin” dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

2. Përveç tyre, termat e tjera vijuese kanë këto kuptime:

a) Subjekte që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi;

b) Ankesë – pretendimet e ngritura për ekzistencën e një sjelljeje që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe aktet të tjera nënligjore, nga një palë e interesuar, e cenuar nga subjektet që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi, duke përfshirë pa asnjë kufizim persona fizikë dhe juridikë, organet e shtetit, që i drejtojnë një ankesë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, “ISHMT”, ndaj këtyre subjekteve, e paraqitur në formë të shkruar dhe që përmban elementët e domosdoshëm të përcaktuar nga kjo rregullore, mbi të cilat të mund të kryhet një verifikim dhe si rrjedhojë e të cilit mund të arrihet në një vlerësim të qartë;

c) Shqyrtim bazuar në ankesë – fillimi i një shqyrtimi duke u bazuar në një ankesë. Ky lloj shqyrtimi ndërmerret sapo Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, “ISHMT”, merr një ankesë të adresuar kundrejt një subjekti që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi, qoftë ky person fizik apo juridik;

d) Sjelljet në shkelje dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore – përfshijnë të gjitha, si dhe çdonjërin nga veprimet e mëposhtme të kryera nga subjekti që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi;

- Kryerja e veprimeve me natyrë antiligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtuese dhe veprimtarive turistike të biznesit;

- Veprimet ose mosveprimet që të çojnë në cenimin e të drejtave dhe interesave të çdo institucioni apo personi;

- Shkeljet e normave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. “93, datë 27.7.2015, “Për turizmin”, në aktet



nënligjore në zbatim të tyre dhe aktet e tjera ligjore në fuqi;

e) Verifikimi mbi bazë ankese – është procesi i njohjes dhe konfirmimit të vërtetësisë së pretendimeve për fakte dhe rrethana që lidhen me veprimtarinë e subjekteve që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi, që realizohet nëpërmjet marrjes, grumbullimit, analizës dhe ballafaqimit të të dhënave konkrete.

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 4

Komisioni i Vlerësimit të Ankesave – KVA

1. Me qëllim të zbatimit të rregullave dhe procedurave të vendosura nga kjo rregullore dhe të akteve të tjera rregulluese për vlerësimin e ankesave, si dhe për të respektuar të drejtat e palëve gjatë këtij procesi, për të garantuar një proces të rregullt ligjorë, pranë “ISHMT”-së, krijohet Komisioni i Vlerësimit të Ankesave (KVA).

2. Komisioni i Vlerësimit të Ankesave është organ në varësi të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut “ISHMT”.

3. KVA-ja ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë. Kryetari dhe 4 (katër) anëtarët e KVA-së, zgjidhen nga Kryeinspektori.

4. Kryetari dhe anëtarët e KVA-së, zgjidhen, 4 (katër), anëtarë përfaqësues nga radhët e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin, përcaktuar kjo në VKM-në, nr. 36, datë 28.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut”.

5. Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të KVA-së.

6.a) një përfaqësues nga njësia që mbulon çështjet juridike, në “ISHMT”;

7.b) një përfaqësues që mbulon çështjet teknike dhe të meteorologjisë së mbikëqyrjes së tregut dhe inspektimit.

8.c) dy nëpunës të tjerë të “ISHMT”-së, të përfshirë në veprimtari të drejtpërdrejta të inspektimit.

9.ç) një specialist i fushës nga Ministria që mbulon çështjet, objekt inspektimi.

10. Funkzioni i anëtarit të KVA përfundon kur:

- Ndaj tij është marrë një nga masat disiplinore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”.

- Kur gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit si anëtar i KVA-së, detyra e tij bie në kushte të papajtueshmërisë me kërkesat e ligjit nr. 10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, ligjit, nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 93, datë 27.7.2015, “Për turizmin”, si dhe VKM-në nr. 36, datë 20.1.2016, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut”.

11. Përveç rasteve sa më sipër, anëtarët e KVA-së mund të shkarkohen me urdhër të Kryeinspektorit, në ato raste kur veprimet apo mosveprimet e tyre, bien ndesh me rregulloren e brendshme të Inspektoratit, apo me dispozita të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

12. KVA-ja përbëhet nga 5 anëtarë dhe funksionon përgjatë gjithë vitit.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së KVA-së

1. Shqyrtimi i sjelljeve në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore, të subjekteve që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi, të cilat ndërmerren bazuar në informacione të raportuara pranë ISHMT-së.

2. Shqyrtimi i ankesave të palëve të interesuara, të cenuara, nga mospërmbushja me korrektësi ligjore e cilësisë së shërbimit, si dhe tregtimi jashtë kushteve dhe standardeve ligjore, i produkteve, nga subjektet që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi, që cenojnë interesat e tyre.

Neni 6

Funksionimi i KVA-së

1. Kryetari i KVA-së, pasi administron kërkesën dhe dokumentacionin e ardhur për shqyrtim, organizon menjëherë dhe ndjek realizimin e procesit shqyrtues i cili duhet të përmbyllet brenda një afati 30 ditor.



2. Mbledhjet e KVA-së, kryesohen nga kryetari i KVA-së dhe në mungesë të tij kryesohen nga anëtari më i vjetër në moshë.

3. KVA-ja mund të marrë vendime të vlefshme dhe të miratojë Raportin e rezultatit informativ dhe konkluzionet vlerësuese, kur në mbledhje janë të pranishëm jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast se kemi vota të barabarta dhe vlerësime të ndryshme për përmbajtjen e raportit dhe marrjen e vendimit për miratimin e tij nga KVA-ja, atëherë vota e Kryetarit është përcaktuese.

4. Në përfundim të procesit të shqyrtimit, KVA-ja duhet të rishikojë evidencën e grumbulluar dhe të marrë vendime për rastin e shqyrtuar prej tij. Dosja me konkluzionet e arritura dhe masat e propozuara i dërgohen Kryeispektorit.

5. Vendimet e KVA-së, pasqyrohen në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në procesin e shqyrtimit të rastit.

6. Procesverbalet e mbledhjeve të KVA-së dhe i gjithë dokumentacioni që shoqëron praktikën shqyrtuese ruhen në selinë e Inspektoratit, në një ambient që siguron konfidencialitetin dhe ruajtjen e informacionit.

7. KVA-ja me qëllim për të përmbushur sipas standardeve dhe në mënyrë korrekte detyrën, mund t'i kërkojë Kryeispektorit, që në përputhje me legjislacionin për inspektimin, të autorizojë një grup inspektorësh, për kryerjen e inspektimit në funksion të objektit të shqyrtimit të ankimit.

Neni 7

Raportimi

1. Raporti i mbajtur nga KVA-ja, pasi është konfirmuar nga të gjithë anëtarët prezentë, i komunikohet palëve të interesuara.

2. Raporti i KVA-së duhet të përmbajë këto elemente:

- një përshkrim i hollësishëm mbi hetimin administrativ të kryer, seancat shqyrtuese që janë zhvilluar gjatë periudhës hetimit dhe dokumentacioni i administruar;

- shkeljet e ligjit dhe akteve nënligjore, që janë konstatuar gjatë procedurës shqyrtuese kundrejt subjektit ndaj të cilit është adresuar ankimi;

- sjelljet ose kryerja e veprimeve konkrete në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, të konstatuara tek subjekti ndaj të cilit është adresuar ankimi;

- propozimet dhe rekomandimet nga KVA-ja, për veprimet që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

NISJA E PROCEDIMEVE DHE PROCESI I SHQYRTIMIT

Neni 8

Ankesa, depozitimi dhe forma e saj

1. Ankesat e ardhura në KVA, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajnë të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana të ekzistencës së sjelljeve në shkelje dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, mbi të cilën mund të fillojë një proces shqyrtimi.

2. Ankesa duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:

a) të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë; dhe

b) të dhëna mbi subjektin/et që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve të ndryshme qofshin këto ushqimore dhe joushqimore, si dhe subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi etj., objekt i ankesës; dhe

c) përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara dhe kohën e ndodhjes së tyre; dhe

d) dokumentet apo burimet mbështetëse të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara.

3. Gjatë procesit të shqyrtimit ankimesi mund të plotësojë dokumentacionin mbështetës me dokumente të tjera që ai i gjen të arsyeshme, si edhe me dokumentacione të tjera që mund t'i kërkojnë nga KVA-ja në funksion të procesit të shqyrtimit, nëse do të jetë rasti.

Neni 9

Shqyrtimi mbi bazë ankese

1. Ankesat ndaj subjekteve që zhvillojnë veprimtarin e tyre në fushën e tregtimit të produkteve joushqimore dhe/ose atyre që ushtrojnë veprimtari turistike biznesi, të cilat regjistrohen në sekretarinë e Inspektoratit, i përcillen për shqyrtim KVA-së, brenda 7 (shtatë) ditëve pune.



2. Kryetari KVA-së, brenda 7 (shtatë) ditëve punë, nga data e marrjes së njoftimit për ankesën, thërret mbledhjen e KVA-së, për shqyrtimin e saj.

3. KVA-ja në mbledhjet e organizuara për shqyrtimin e ankesave merr vendim lidhur me:

- lëndën objekt verifikimi;
- detyrat e verifikimit;
- dokumentacionin shtesë që mund të kërko-het për kryerjen e shqyrtimit;
- afatin e kryerjes së verifikimit.

4. Përfundimi i verifikimit të ankesës nga KVA-ja, bëhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e fillimit të procesit të shqyrtimit. Ky afat mund të shtyhet me vendim të KVA-së me kërkesën e palëve, për shkaqe të argumentuara, të arsyeshme të bazuara në ligj.

5. Nuk merren në konsideratë ankesat anonime.

Neni 10

Kryerja e shqyrtimit dhe dokumentimi i tij

1. KVA-ja ka përgjegjësinë e trajtimit të sigurt dhe konfidencial të dokumenteve dhe evidencës që merr nga palët, e veçanërisht për mbrojtjen e interesave të ankuesit dhe të subjektit ndaj të cilit është adresuar ankesa.

2. Për të përmbushur misionin e tij, KVA-ja ka të drejtë t'u kërkojë subjekteve dhe palëve të treta informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në konkluzionet e duhura për çështjen që merren në shqyrtim.

3. Informacionet dhe dokumentacioni i kërkuar nga KVA-ja duhet t'i vihet në dispozicion KVA-së, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike duke filluar nga e nesërmja e marrjes së kërkesës.

4. Për efekt të marrjes së njoftimit, do konsiderohet marrë njoftimi nëpërmjet komunikimit shkresor të protokolluar, si dhe me postën elektronike (*e-mail-it*) zyrtare dhe me telefon nga KVA-ja.

5. Vendimi i KVA-së, duhet të shoqërohet me një relacion të përshkruar në mënyrë të detajuar, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e verifikimit;
- pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit;
- pretendimet e arsyetuara me shkrim apo verbalisht, të pasqyruara në procesverbalin e seancës, që janë paraqitur nga subjekti i proceduar;

- referencë të dokumenteve, faktet dhe rrethanat që përbëjnë shkëlje, në referim të ligjit dhe akteve nënligjore;

- përmbledhjen e të dhënave kryesore të rastit të verifikuar;

- përfundimet nëse ekzistojnë në rastin konkret shkëlje të ligjit, nëse ato përbëjnë ose jo shkaqe të arsyeshme për marrjen e masave ndëshkuese administrative;

- propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të verifikimit.

Neni 11

E drejta e përfaqësimit

1. Gjatë seancave hetimore administrative, të shqyrtimit të ankesës, KVA-ja duhet të udhëhiqet nga parimi i paanshmërisë, barazisë dhe i respektimit të të drejtave të njeriut, trajtimit të palëve në mënyrë të barabartë, duke iu garantuar atyre të drejtën e pjesëmarrjes në çdo seancë të hetimit administrativ, vënien në dispozicion të provave dhe fakteve të mbledhura gjatë hetimit, si dhe dhënien e mundësisë për t'u mbrojtur, vetë ose me përfaqësues ligjorë të zgjedhur prej tij, si dhe për të paraqitur prova.

2. Kur e gjykon të nevojshme, KVA-ja organizon seanca dëgjimore me palët e përfshira në procesin shqyrtues.

ADMINISTRIMI I PROCESIT SHQYRTUES

Neni 12

Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit

1. Për çdo çështje (praktikë) shqyrtimi hapet një dosje sipas një modeli të caktuar nga KVA-ja, me një referencë lidhëse të përshtatshme, e cila administrohet në arkivin e Inspektoratit. Kjo dosje përmban detyrimisht të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë procesit shqyrtues, administrativ që nga fillimi i tij deri në përfundimin e procesit.

2. Në çdo mbledhje të KVA-së, mbahet një procesverbal, ku pasqyrohen data, vendi, rendi i ditës, anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejtuesi i saj, çështjet që janë diskutuar, forma dhe rezultati i votimeve. Në fund të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

3. Kryeinspektori është përgjegjës për marrjen në kohë të të gjitha masave për asistimin e KVA-së, në çështjet administrative, sekretariale dhe logjistike.



VENDIM
Nr. 3, datë 31.5.2016

**PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA
PRODUKTET E DUHANIT**

Sot në datën 31.5.2016, u mblodh Komiteti Ndërsektorial, për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit (KNMSHPD), me pjesëmarrjen si më poshtë vijon:

- Z. Ilir Beqaj, ministër i Shëndetësisë	kryetar;
- Znj. Irena Beqiraj, zëvendësministër i Financave	anëtar;
- Z. Rauf Dimraj, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
- Z. Stefan Çipa, zëvendësministër i Brendshëm	anëtar;
- Z. Zef Çuni, zëvendësministër i Kulturës	anëtar;
- Z. Arjan Bregu, drejtor i Institutit të Shëndetit Publik	anëtar;
- Z. Eltar Deda, kryeinspektor shtetëror shëndetësor	anëtar.

Funksionet e sekretarit të KNMSHPD-së kryhen nga drejtori i Institutit të Shëndetit Publik Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit vendosi uninamisht si vijon:

1. Vendosjen në paketat e duhanit të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit në shëndet, jo vetëm përmes teksteve, por edhe përmes një serie fotografish të “Sëmundjeve të tmerrshme”.

2. Adaptimin në mënyrë graduale të masës së sipërcituar, duke nisur fillimisht me paralajmërimet shëndetësore grafike të detyrueshme në ambalazhin e çdo pakete.

3. Ministria e Shëndetësisë të fillojë nga puna për përzgjedhjen e logos(ve), të cilat do të vendosen në paketën e duhanit dhe në mbledhjen e radhës të KNMSHPD-së këto logo do të kalojnë për miratim.

4. Data e hyrjes për tregtim të paketave me logot e reja do të jetë 1.1.2018.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KOMITETIT
NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN E
SHËNDETIT NGA PRODUKTET E
DUHANIT
Ilir Beqaj

KËRKESË

Nr. 5317, datë 29.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës “Kosova”, Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni pronarët, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 165, 312, 977 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Alfred Dalipi

Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga projekti “Ndërtimi i Shkollës “Kosova”.

Nr	EMER	MBIEMER	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	SIP. Tr. të prekur (m ²)	Çmimi Truallit lek/m ²	SIP. Obj. të prekur (m ²)	Çmimi Obj.lek/m ²	Vlera në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë	
1	Bashkpron.	Grabocka, Kapo, Zere.	8160	2/76	2468,5	66,969	145	0	165,312,977	Shkr.nr.prot.9049/1, dt.18.04.16 Shkr. nr.prot.9049/3, dt.06.06.16	
									Shuma	165,312,977	lekë

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.

2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM nr.138, dt.23.03.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB, për vitin e ndërtimit dhe amortizimin referoju faqes në vijim.

**KËRKESË****Nr. 4766, datë 4.10.2016****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë–Elbasan (shtesa)”, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “objekte”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “objekte”. Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 53 424 593 (pesëdhjetë e tre milionë e katërqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË - ELBASAN (SHTESA)"

Nr.	PRONARI Emri i pronarit	ZK	NR. PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE	VLERËSIMET			Sip. e banesave (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Banesat vlera (lekë)	VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
						SIP (M ²)	CMIMI (LEKË/M ²)	Vlera(lekë)					
1	Zylfje Tahir Metani	2735	113/13	Arë	1500	287	399	114513				114513	Konfirmim ZVRPP
2	Zamir Rexhep Metani	2735	113/4	Arë	2050	361	399	144039				144039	Konfirmim ZVRPP
3	Zamir Rexhep Metani	2735	125/9	Arë	5000	3261	399	1301139				1301139	Konfirmim ZVRPP
4	Zamir Rexhep Metani	2735	125/2	Arë	625	625	399	249375	372.7	64500	24039150	24288525	Konfirmim ZVRPP + Leje ndërtimi 3 kt
5	Zamir Rexhep Metani	2735	115/3	Arë	510	510	399	203490				203490	Konfirmim ZVRPP
6	Bashkëpronarët Metani	2735	115/2/1	Truall	300	300	3560	1068000	100	64500	6450000	7518000	Konfirmim ZVRPP
7	Shtet	2735	115/5	Truall	300	300	3560	1068000	77.5	64500	4998750	6066750	(pretendon Ramazan Metani)
8	Bashkëpronarët Metani	2735	115/3/1	Truall	300	300	3560	1068000	120	64500	7740000	8808000	Konfirmim ZVRPP
9	Shtet	2735	115/4	Truall	250	130	3560	462800	48.15	64500	3105675	3568475	Konfirmim ZVRPP (pretendon Ali Metani)
10	Selman Dervishi	2735	125/13	Arë	1300	816	399	325584				325584	Konfirmim ZVRPP
10	Selman Dervishi	2736	125/14	Arë	1300	816	399	325584				325584	Konfirmim ZVRPP
10	Selman Dervishi	2737	125/15	Arë	1300	816	399	325584				325584	Konfirmim ZVRPP
11	Selman Dervishi	2735	127/4	Arë	5800	1090	399	434910				434910	Konfirmim ZVRPP
TOTALI						9612		7091018	718.35		46333575	53424593	



KËRKESË

Shtetasi Naim Zaza, i datëlindjes 17.8.1935, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të vdekur të xhaxhait të tij, shtetasit Haxhi Zaza, i biri i Mustafait dhe i Hazbijes, i datëlindjes 3.12.1908, vendlindja Durrës.

KËRKUESI
Naim Zaza

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 144, datë 25.8.2016 “Për miratimin e kontratës tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.7.2016–31.12.2016”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.165, datë 5.9.2016 bëhet ndreqja e gabimit material në vlerën e tabelës, e cila ishte **1,704,9** dhe bëhet **1.834.962**.

ANEKSI 1

PARASHIKIMI I PRODHIMIT NGA KESH SHA PËR PERIUdhËN
KORRIK–DHJETOR 2016

Ishte:

- Regjimi për prodhim kontraktual (shfrytëzim racional)

Treguesit	njësia	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	6-mujori	
Shfrytëzimi korrik-dhjetor 2016 (prurjet llogaritëse 75 siguri)	Prurja Fierzë, me 75% sig.	m ³ /sek	57	41	49	62	115	156	80
	Niveli në Fierzë në fillim	m	295.42	291.05	285.08	280.19	276.16	276.04	
	Niveli në Fierzë në fund	m	291.05	285.08	280.19	276.16	276.04	277.70	
	Prodhimi bruto KESH GEN	GWh	319.8	315.5	263.2	253.2	263.5	289.6	1,704.9
	KESH Gen për FSHU	GWh	302	312	285	275	300	326	1,800

Bëhet:

ANEKSI 1

PARASHIKIMI I PRODHIMIT NGA KESH SHA PËR PERIUdhËN
KORRIK - DHJETOR 2016

- Regjimi për prodhim kontraktual (shfrytëzim racional)

Treguesit	njësia	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	6-mujori	
Shfrytëzimi korrik-dhjetor 2016 (prurjet llogaritëse 75 siguri)	Prurja Fierzë, me 75% sig.	m ³ /sek	57	41	49	62	115	156	80
	Niveli në Fierzë në fillim	m	295.42	291.05	285.08	280.19	276.16	276.04	
	Niveli në Fierzë në fund	m	291.05	285.08	280.19	276.16	276.04	277.70	
	Prodhimi bruto KESH GEN	GWh	319.8	315.5	263.2	253.2	263.5	289.6	1,834.962
	KESH Gen për FSHU	GWh	302	312	285	275	300	326	1,800.000

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë